REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.22, datë 23/05/2005

"MBI FINANCIMIN E REALIZIMIT ARTISTIK DHE VENDOSJEN E BUSTIT TË "HEROIT TË POPULLIT" MYSLYM KETA, NË SHKOLLËN ME TË NJËJTIN EMËR NË NJËSINË BASHKIAKE NR.6 TË TIRANËS"

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve "Mbi financimin e realizimit artistik dhe vendosjen e bustit të "Heroit të Popullit" Myslym Keta" në shkollën me të njëjtin emër në Njësinë Bashkiake Nr.6 të Tiranës", mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 10, paragrafi II, gërma "a" dhe neni 32, gërma "l",

V E N D O S I;

1. Të miratojë financimin në vlerën 300.000 lekë për realizimin e bustit të "Heroit të Popullit" Myslym Keta, që do të vendoset në shkollën me të njëjtin emër në Njësinë Bashkiake Nr.6.

2. Efektet financiare të pikës 1 do të mbulohen duke pakësuar me këtë shumë fondin e investimeve të Bashkisë Tiranë nga të ardhurat në zërin "Pajisje zyrash".

3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI